

Nga: Dr. Bernard Tahirbegolli, Kordinaror i KosADA

Lënda: Raport i punës i KosADA, për periudhën Janar-Dhjetor 2024

KosADA gjatë vitit 2024 ka vazhduar të ushtroj rolin e NADO konform obligimeve të dala nga nënshkrimi i Kodit Botëror për Anti Doping nga Presidenti i Komiteti Olimpik të Kosovës.

Në fillim të vitit 2024 kemi kaluar me sukses vlerësimin e WADA sipas Standardit Ndërkombëtar dhe procedurës së Code Compliance Questionnaire, për organizimin, funksionimin dhe vprimtarinë e NADO.

Si pjesë e programit nacional për anti doping është vazhduar me edukimin dhe vetëdijësimin e komunitetit të sportit për anti dopingun gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024, duke i realizuar seminarët antidoping me:

- FC Ballkani-seniorët
- FC Drita-seniorët
- Federata e Hendbollit –Femrat U18
- Kombëtarja e Kosoës U18 në Hendboll, meshkujt dhe femrat
- Federata e Triathlonit e Kosovës
- Kombëtarja e Kosovës U16 në Hendboll, meshkujt dhe femrat
- FC 2 Korriku- Junioret
- Kombëtarja e Kosovës U17 në Futboll, meshkujt
- Komiteti Paralimpik i Kosovës

Po ashtu kemi realizuar edukimin antidoping para përfshirjes në Listën e Regjistruar për Testim me Federatën e Notit, Federatën e Mundjes, Federatën e Taekwondosë, Federatën e Boksit,

Me qëllim të parandalimit të dopingut në sport dhe monitorimit të respektimit të Kodit Botëror Anti Doping dhe Rregullave Kombëtare Anti Doping janë realizuar gjithësej 117 testime për kontrollë të dopingut, prej tyre 51% ishin brenda garave dhe 49% jashtë garave.

Kemi mbedhur 10 mostra në garën ndërkombëtare, Muaythai European Championship Prishtina 2024, në bashkëpunim me International Testing Agency dhe International Federation of Muaythai Associations.

Kemi bashkëpunuar me Athletic Integrity për RM për testimet e bëra në Prishtina Marathon 2024.

Kemi bashkëpunuar me USADA për testimin e sportistëve kosovarë gjatë qëndrimit në SHBA, si dhe kemi bashkëpunuar me TDMK për testimin e sportistëve kosovarë gjatë qëndrimit të tyre në Turqi.

Për herë të parë kemi mbledhur 3 mostra të gjakut jashtë garave në tri diciplina sportive të ndryshme.

Është realizuar me sukses transporti i mostrave përmes zingjirit të ftohtë në laboratorin e antidopingut në Siebersdorf dhe kemi pranuar rezultatet në ADAMS.

Testimet për kontrollë të dopingut janë bërë në 24 diciplina nga sportet në vijim: Futboll, Basketboll, Hendboll, Volejboll, Çiklizëm, Xhudo, Karate, Atletikë, Mundje, Triatlon, Not, Boks, Skitari, Shigjetari, Shenjëtari Sportive, Para-Atletikë, Taekwondo.

Është përditësuar dhe mirëmbajtur Lista për Testim dhe Lista e Regjistruar për Testim e sportistëve kosovar të vlerësuar sipas pikëve të riskut.

Kemi bashkëpunuar me of International Judo Federation, International Testing Agency dhe Hellenic Anti-doping Agency, për menaxhimin e llogarive të sportistëve Kosovar në ADAMS.

Nga testimet e bëra kemi gjetur dy shkelje të Regullave Kombëtare Anti Doping dhe Kodit Botëror Antidoping neni 2.1 dhe neni 2.2.

Shkeljet kanë ndodhur nga dy basketbollist dhe janë identifikuar nga testimet e bëra gjatë testimeve në gara, përkatësisht në Superligën e Basketbollit. Rastet janë bërë publike konform Regullave Kombëtare Antidoping, Ligjit për Antidopingun dhe Kodit Botëror Antidoping.

Procesi i menaxhimit të rezultateve për të dy shkeljejt është përfunduar në shkallën e parë dhe nuk ka pasur procedura ankimore të mëtejme në shkallë të tjera.

Janë inicuar tri raste hetimore për identifikimin e shkeljeve të supozuara të regullave antidoping, njëra ishte nga raportimet anonime në aplikacionin në web faqe dhe dy të tjerat me vet procedurat e KosADA.

Gjatë vitit 2024 janë shqyrtuar dy aplikime të sportistëve për Përdorimin e Përgjashtuar Terapeutik.

Kemi shënuar me 14 Prill, Play True Day duke u bashkuar me WADA në vetëdijësimin e komunitetit të sportit për një sport të pastër dhe pa doping.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të KosADA kemi marr pjesë në:

- WADA Global Education Conference, në Shkurt, Cannes, Francë
- Simpoziumi i 25'të vjetor i WADA, në Mars, Lousane, Zvicër.
- UEFA Anti-Doping workshop, Nyon, Zvicër

Kemi prezantuar për ndryshimet regullative në fushën e antidopingut në legjislacionin vendor, në Tyezën e Sportit të organizuar nga MKRS, në Shkurt 2024.

Kemi mirëpritur për vizitë në Prishtinë, Drejtorin e WADA për Evropë, z. Sebastien Gillot dhe Drejtorin e SLOADO z. Janko Dvorsak, në Mars 2024.

Kemi organizuar Panel Diskutimi me temën e Anti Dopingut në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës dhe me panelistë Drejtorin e WADA për Evropë, z. Sebastien Gillot, Drejtorin e SLOADO z. Janko Dvorsak, dhe Kordinatorin e KosADA z. Bernard Tahirbegolli.

Kemi përditësuar materialet e publikuara në web faqe në lidhje me anti dopingun konform kërkesave të Kodit Botëror Anti Doping dhe Regullave Kombëtare Anti Doping.

Kemi marr pjesë në grupet punuese të MKRS për hartimin e akteve nënligjore të derivuara nga Ligji për Anti Dopingun.

Duke qenë se aktivitetet e KosADA kanë qenë të planifikuara për pjesën e parë të vitit 2024 në mënyrë që kompetencat të transferohen në pjesën e dytë të vitit 2024 tek Agjencia Antidoping sipas Ligjit për Antidopingun, një transferimi I kompetencave nuk ka mundur të realizohet për shkak të dështimit të konkurseve për zgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë Antidoping.

Në muajin Shtator kemi bërë kërkesë në MKRS për të vazhduar mbështetjen financiare për aktivitetet e KosADA por nuk na janë përgjigjur pozitivisht.

Për rjedhje jemi detyruar të përditësojmë planin vjetor të testeve të cilin e kishte mirratuar paraprakisht WADA gjatë vlerësimit me Code Compliance Questionnaire për KosADA, duke e reduktuar kështu numrin e testeve për vitin 2024. Me këtë rast WADA është njoftuar që për shkak të kufizimeve buxhetore nuk po mund të realizohet plani i aprovuar i testeve dhe I njeiti është përditësuar duke e zvogëluar numrin e testeve.

Në takimin që kishim me UD Drejtorin e Agjencisë Antidoping z. Feim Hoxha në muajin Nëntor 2024, jemi dakorduar që aktivitetet antidoping të KosADA të mos ndalen derisa Agjencia Antidoping të konsolidoj kapacitetet operuese dhe funksionale për testim, edukim, menaxhim të rezultateve dhe shqyrtimit të aplikimeve për lejet për përdorimin e përjashtuar terapeutik.